

4.4 AUTONIVELANT EPOKSID

EPO-FLOOR EC 0.3



Njësia matëse	copë/paletë	Konsumi	Ngjyra/specifikime të tjera
25 kg/thes 5 kg/kovë 5 kg/kovë	54 cp/paletë 36 cp/paletë 36 cp/paletë	1.5 kg/m ² /mm	Gri



EPOFLOOR EC 0.3

Vetënivelues me bazë epokside, 3 komponentësh.

PËRSHKRIMI

EPOFLOOR EC 0.3 është një produkt nivelizues me bazë rezinash epokside,

si dhe nuk përmban solvent. Ofron avantazhet e mëposhtme:

- Rezistenca të larta mekanike.
- Lidhje shumë e mirë me sipërfaqen ku aplikohet.
- Rezistencë e lartë ndaj lagështisë.
- Ka aftësi shumë të mira nivelizuese.
- Nuk ka efekt korrodues.

Klasifikohet si SR - B2,0 - ARO,5 - IR4 sipas EN 13813.

FUSHAT E APLIKIMIT

EPOFLOOR EC 03 përdoret si shtresë niveluese në dyshemetë me bazë çimento për ti dhënë rezistenca të larta mekanike dhe kimike. Është i përshtatshëm për aplikim në zonat industriale, magazina, parkingje, supermarkete, laboratore, hotele, garazhe, pika karburanti si dhe zona me trafik të rënduar. Gjithashtu është i përshtatshëm për të qenë një kontakt direkt me produkte ushqimore, sipas legjislationit W - 347, ISO 8467.

UDHËZIME PËR PËRDORIM

1. Sipërfaqja

Sipërfaqja ku do të aplikohet duhet të jetë:

- E qëndrueshme dhe e thatë ose me pak lagështi, pa praninë e ujit.
- E pastër, pa materiale që parandalojnë lidhjen, të tilla si pluhuri, grimca të lirshme, yndyrna, etj
- E mbrojtur nga lagështia.

2. Astarosja

Në sipërfaqe duhet të aplikohet astari EPOXY PRIMER W 4000. Konsumi 200 – 300 g/m². Pasi astari të jetë tharë, dëmtimet ekzistuese si pla-

saritjet dhe gropat duhet të mbushen duke përdorur EPOFLOOR EC 0.3 (A+B+C) e përzier me rërë kuarcore me granulometri 0 – 0.3 mm. EPOFLOOR EC 03 duhet të aplikohet 24 orë pas aplikimit të astarit.

2. Përzierja e EPOFLOOR EC 0.3

Komponentët A dhe B janë paketuar në proporcione të paracaktuara përzierje. Fillimisht, komponenti A duhet të përzier mirë në enë e tij. Më pas e gjithë sasia e komponentit B duhet të shtohet në komponentin A. Përzierja e dy komponentëve duhet të vazhdojë për rreth 30 sekonda, me një mikser me shpejtësi të ulët (300 rpm). Është e rëndësishme që të bëhet një përzierje e mirë pranë anëve dhe në fund të kovës, për të aritur një shpërndarje uniforme të sforcuesit. Përzierja bëhet me një mikser me shpejtësi të ulët dhe vazhdohet deri sa përzierja të bëhet plotësisht uniforme (për rreth 3 minuta). Më pas, shtohet gradualisht rërë kuarcore me granulometri 0 – 0.4 mm nën përzierje të vazhdueshme, deri në raportin 1:2 në peshë derisa një masë llaçi epoksid të formohet.

3. Mënyra e aplikimit - Konsumi

Në varësi të sipërfaqes finale ka dy mënyra aplikimi:

a) Sipërfaqe finale e lëmuar

Përzierja epokside hidhet në dysheme në trashësi 2 – 3 mm dhe hapet duke përdorur një mallë të dhëmbëzuar. Konsumi i EPOFLOOR EC 0.3(A+B) është 0.6 Kg/m² për mm trashësi. Konsumi i rërës kuarcore 1.2 Kg/mm² per mm trashësi. Shtresa niveluese duhet të kalohet me një rrul me gjemba në mënyrë që të largohet ajri i mbetur brenda shtresës dhe të evitohen hapësirat boshe.

b) Sipërfaqe finale e ashpër

Fillimisht përzierja epokside aplikohet në mënyrën që u shpjegua në pikë a) për sipërfaqet e lëmuara. Kur shtresa është akoma e pa forcuar, sipas dëshirës hidhet mbi produkt rërë kuarcore me granulometri 0 – 0.4 mm ose 0.4 – 0.8 mm. Konsumi i rërës kuarcore është afërsisht 3 Kg/m². Pas forcimit të EPOFLOOR EC 0.3, pjesa e pa lidhur e rërës largohet duke përdorur fshesë me vakuum. Në fund një shtresë EPOFLOOR EC 0.3 aplikohet me rrul. Konsumi është 400 – 600 g/m².



PAKETIMI

EPOFLOOR EC 0.3 është i disponueshëm në paketim 30 Kg (A+B+C).

JETËGJATËSIA DHE RUAJTJA

24 muaj nëse ruhet në paketim origjinal dhe të pahapur e të paeksponuar ndaj rrezeve të diellit dhe ngricës.



TË DHËNAT TEKNIKE

Baza kimike (A+B+C)	rezine epokside 2 komponentëshe dhe rërë kuarci
Densiteti (A+B+C)	2,1 Kg/l
Raporti Përzierjes (A:B:C)	5: 1: 6 në peshë
Jetëgjatësia	afërsisht. 40 min në +20°C
Temperatura minimale për forcim	+8°C
Shkelet	pas 24 hours at +23°C
Rezistencat finale	pas 7 days at +23°C
Rezistenca në shtypje	110 N/mm ² (EN 13892 - 2)
Rezistenca në perkulje	62 N/mm ² (EN 13892 - 2)
Forca ngjytëse	4 N/mm ² (pika e thyerjes së betonit)
Trashësia maksimale	3 mm